

Nr. 5032 prot

Tiranë 31.05.2019

**Raporti i audituesit**

**Mbi verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të**

**Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile**

Përgatiti: Zamir HOXHA



## Raport i Auditimit

Drejtuar : **Komisionit Qendror te Zgjedhjeve**

Të nderuar anëtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në zbatim të vendimit Nr. 38, datë 26.12.2018, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019” dhe udhëzimit Nr.2, datë 28.12.2012 të KQZ “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe në sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV), ju paraqes më poshtë raportin e auditimit të kryer për periudhën ekstrakte tretë për periudhën Shkurt 2019.

Përgjegjësia e audituesit është të verifikojë përputhshmërinë e veprimeve të kryera nga DPGJC me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, ligjin për “Gjendjen Civile” dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.

Tabelë përmbledhëse

<b>Hyrje</b> .....	4
<b>Baza Ligjore</b> .....	4
<b>Administrimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile</b> .....	6
<b>Gjenerimi i ekstraktit zgjedhor</b> .....	7
<b>Situata e ekstraktit zgjedhor</b> .....	8
<b>Opinion</b> .....	15
<b>Shtojca</b> .....	17

## Hyrje

Në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, sipas dekretit Nr.10928 të Presidentit të Republikës, datë 05.11.2018, do të zhvillohen më datë 30 qershor 2019 nëpërmjet vendimit Nr. 38, datë 26.12.2018, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për emërimin e auditit teknikien për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve është bërë caktimi im si Auditues Teknikien.

Në zbatim të detyrës të caktuar kontrolli i ekstraktit të përbërësve zgjedhor përfshin në përgjithësi:

- Njohjen me procedurat e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile pranë Ministrisë të Brendshme si dhe me raportimin e Zyrave të gjendjes Civile pranë kësaj drejtorie deri në datën e raportimit
- Kryerja e procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi
- Verifikimi mbi masat e ndërmarra për sigurimin e integritetit të bazës së të dhënave dhe mbi procedurat e mirëmbajtjes dhe administrimit të sistemeve të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile

## Baza Ligjore

- Ligji Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin Nr.74/2012, datë 19.07.2012 dhe ligjin Nr.31/2015, datë 02.04.2015
- Ligji Nr.10129, datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile", i ndryshuar me ligjin Nr.6/2012, datë 02.02.2012, ligjin Nr.130/2013 datë 25.04.2013, ligjin Nr.134/2016 datë 22.12.2016 dhe ligjin Nr.69/2018 datë 11.10.2018.



- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”
- VKM Nr.365, datë 11.6.2004 “Për krijimin e mënyrën e mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile dhe për rregullat e shfrytëzimit të teknikës dhe rrjetit informatik”.
- VKM Nr.673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar me Vendimin e KM Nr.36, datë 24.01.2018, Vendimin e KM Nr.88, datë 14.02.2018 dhe Vendimin e KM Nr.448, datë 26.07.2018.
- VKM Nr. 945, datë 2.11.2012 “Për Miratimin e Rregullores ‘Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”
- VKM Nr. 710 datë 21 gusht 2013 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” i ndryshuar,
- VKM 222 date 26.4.2018 “Për miratimin e listës se infrastrukturave kritike te informacionit dhe listës se infrastrukturave te rëndësishme te informacionit”
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.295/1, datë 06.11.2018 “Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”.
- Udhëzimit të Ministrit të Punëve të Brendshme, Nr.225, datë 11.05.2016 “Për procedurat e pezullimit nga lista e zgjedhësve për shtetasit që vuajnë dënimin e parashikuar nga Ligji Nr.138/2015 “Për garantimin e personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”.
- Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm Nr.370, date 07.12.2012 “Për procedurat e pastrimit të dublimeve të shtetasve shqiptarë nga regjistrat themeltarë dhe Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”.
- Udhëzimit të KQZ-së Nr.2, datë 28.12.2012 “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknikien për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) dhe ne sistemin elektronik të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV)
- Ligjit Nr.2 datë 2017 , "Për Sigurinë Kibernetike"

## **Administrimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile**

Baza e të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile (referuar si RKGJC në vijim) është themeluar në Korrik të 2008 dhe është vënë në shërbim në janar të vitit 2010 dhe në zbatim të VKM Nr. 945, datë 2.11.2012 "Për Miratimin e Rregullores 'Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore'" është bërë regjistrimi i saj si bazë shtetërore me nivelin e sigurisë të deklaruar L-D3I3K2. Nëpërmjet VKM 222 datë 26.4.2018 "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit" është bërë klasifikimi i saj si infrastrukturë kritike e informacionit. RKGJC, siç përcaktohet në Kodin Zgjedhor, shërben si burim bazë ku ruhen, administrohen dhe përpunohen përbërësit zgjedhorë të shtetasve shqiptarë, individualisht dhe në tërësi. Nisur nga rëndësia e madhe që ka RKGJC është e nevojshme të garantohet që kjo bazë të dhënash administrohet, ruhet dhe përpunohet në mënyrë sa më të sigurtë dhe transparente.

Siç është dokumentuar dhe në raportet e më përparshme administrimi i RKGJC nga ana e DPGJC nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në mënyrë të veçantë me "Rregulloren mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë", të Autoriteti Kombëtar Për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) e nxjerrë në zbatim të Ligjit Nr.2 datë 2017 , "Për Sigurinë Kibernetike", fakt ky që ka bërë që AKSHI të ndërpresë aktivitetin e tij auditues gjatë vitit 2018 deri në plotësimin e dokumentacionit në përputhje me nivelin e sigurisë të sistemit.

Për shkak se mungojnë informacionet e detajuara teknike të ndërtimit, konfigurimit dhe ndërlidhjes të elementeve të bazës të të dhënave dhe sistemit, ndonëse ky dokumentacion është detyruar për regjistrimin e bazës të të dhënave sipas VKM Nr. 945, datë 2.11.2012 "Për Miratimin e Rregullores 'Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore'", është pamundësuar eksporti i të dhënave të ndryshme që kanë të bëjnë me gjurmimin e veprimeve të përdoruesve në sistem dhe ndryshimeve të kryera mbi të dhënat e zgjedhësve dhe elementëve zgjedhorë.



Dokumentimi i plotë i mënyrës të gjurmimit të veprimeve të përdoruesve në sistem dhe detajimi i elementëve teknikë rrit garancitë për transparencën e veprimeve dhe integritetin e të dhënave në sistem. Gjithashtu pamundësia e stafit të DPGJC për të eksportuar dhe vënë në dispozicion log të kërkuar, përveçse kufizimit kryerjen e analizave apo kontrolleve të ndryshme, cënon besueshmërinë dhe mundëson fshehjen e abuzimeve.

Administrimi dhe përpunimi i bazës së të dhënave jo në përputhje me kërkesat teknike dhe administrative të legjislacionin në fuqi ka sjellë limitime në analizat dhe vlerësimet e mundshme në lidhje me veprimet e përdoruesve mbi elemente zgjedhorë duke cënuar besimin ndaj veprimeve të kryera gjatë proceset të hartimit të listave zgjedhore.

Gjithashtu raportohet se antarët e stafit IT që kanë marrë trajnime specifike mbi sistemin nuk janë më punonjës të këtij institucioni dhe stafi aktual nuk ka marrë trajnime të tilla duke pamundësuar njohjen e sistemit dhe nxjerrjen e informacioneve të kërkuara për të siguruar një vlerësim të plotë mbi besueshmërinë e procesit.

### **Gjenerimi i ekstraktit zgjedhor**

Siç është raportuar në vazhdimësi një nga problematikat e hasura gjatë procesit të auditimit ka qenë verifikimi faktik i procesit të gjenerimit dhe mbi kontrollet dhe procedurat e implementuara nga ana e DPGJC në gjenerimin e ekstraktit zgjedhor

Pas mos lejimit tim nga ana e DPGJC për të ndjekur nga afër procesin e gjenerimit të ekstraktit zgjedhor në muajin Shkurt me argumentin se ai është një proces i brendshëm i DPGJC, dhe pas gjenerimit të ekstraktit në muajin Mars para datës të parashikuar, në kundërshtim me deklaratimet dhe informacionin e dhënë nga ana e DPGJC se ky proces zhvillohej pas mbylljes të ambasadës shqiptare në SHBA dhe në fundjavë, pas ndërhyrjeve të vazhdueshme të Drejtorit të IT të KQZ nga ana e DPGJC u lejua që unë të asistoj në procesin e gjenerimit të ekstraktit zgjedhor. Ashtu siç ishte bërë me dije në takimet paraprake, në përfundim të gjenerimit të procedurës të gjenerimit të ekstraktit zgjedhor konfirmohet që i gjithë procesi i përpunimit dhe përgatitjes të

tij zhvillohet në një ambient apo sistem teknik paralel i cili nuk figuron në asnjë dokument dhe nuk rezulton të jetë i regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.

Siç është raportuar dhe në raportet e mëparshme hapat e gjenerimit të ekstraktit zgjedhor fillojnë me ekzekutimin e procedurës të backup, importin në një program tjetër jashtë sistemit të RKGJC, dhe pastaj ekzekutimi i kodeve (script) duke bërë filtrimin e shtetasve të cilët nuk kanë mbushur moshën 18 vjeçare në ditën e zgjedhjeve dhe shtetasit të cilët kanë mbushur 100 vjeç në datën e zgjedhjeve dhe që kanë kodin e QV 8899, personave të cilët janë të dënuar dhe preken nga ligji Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kanë kodin e QV 7788, kontrollohet QV të cilat janë nën limit apo mbi limit etj, deri në realizimin e listës finale.

Nga ana e stafit të DPGJC raportohet që komandat dhe kodet e ekzekutuara për këtë proces kanë qenë të zhvilluara nga kompania e cila ka bërë ngritjen e sistemit dhe nga persona të cilët kanë punuar dikur pranë kësaj drejtorie. Gjithashtu raportohet që nuk ka dokumentim të detajuar se çfarë fushash thërriten, përpunohen apo transformohen nga këto komanda apo kode të përdorura për gjenerimin e ekstraktit zgjedhor. Mungesa e dokumentimit të detajuar teknik i kodeve dhe komandave të ekzekutuara i bën këto veprime jo transparente dhe pamundëson verifikimin dhe vërtetimin e efekteve të komandave të ekzekutuara mbi listat.

Përveçse ky proces i gjenerimit të ekstraktit zgjedhor zhvillohet në kundërshtim total me legjislacionin në fuqi, ka rezultuar gjithashtu se kontrollet e zbatuara gjatë këtij procesi, kanë rezultuar jo efikase dhe në ekstrakte ka pasur qendra votimi me nën limit apo mbi limit siç dhe janë evidentuar dhe në raportet e mëparshme.

### **Situata e ekstraktit zgjedhor**

- Ekstraktet janë gjeneruar brenda afateve ligjore në respekt të pikave 5 dhe 7, të nenit 51 të Kodit Zgjedhor,
- Është publikuar online lista e zgjedhësve në adresën:



<http://134.0.58.65/votinglistapp/>

sipas përcaktimeve të pikës ç), të nenit 48 të Kodit Zgjedhor.

Në mënyrë të vazhdueshme nga ana e DPGJC është raportuar që është mundësuar Identifikimi zgjedhësve me kode banimi 000, 888, 999 i cili ka ardhur duke u ulur nga 284,065 në ekstraktin e parë datë 4 Dhjetor 2018, në 727 në listën finale. Në takimet e zhvilluar në ambientet e DPGJC në fillim të procesit të auditimit është raportuar që ky numër i madh i vjen si pasojë e mos paraqitjes të qytetarëve pranë ZGJC për të përditësuar të dhënat e tyre. Për zgjidhjen e kësaj problematike është raportuar që nga ana e Ministrit të Brendshëm është zhvilluar dhe një takim me stafin e ZGJC dhe përfaqësues të pushtetit vendor të zyrave të urbanistikës.

Referuar ligjit të Gjendjes Civile dhe procedurave të ZGJC rezulton që së paku nga zgjedhjet e kaluara të vitit 2017 deri në gjenerimin e ekstraktit të parë në Dhjetor 2018, **284.065 qytetarë** nuk janë paraqitur pranë ZGC për të marrë shërbimet e kësaj të fundit pasi në të kundërt ata do kishin bërë plotësimin e detyruar të të dhënave që lidhen me adresën e banimit duke sjellë dhe në mënyrë automatike dhe plotësimin e kodit të saktë të banesës. Gjithashtu dhe projekti i Regjistrat Kombëtar të Adresave (RKA), i konsideruar si i suksesshëm nga ana e DPGJC, ndonëse parashikonte eliminimin e kësaj problematike në mënyrë të paqartë nuk ka dhënë asnjë efekt për identifikimin e tyre. Referuar komunikimit me email të dokumentuar në raportet e mëparshme dhe takimeve të zhvilluara në DPGJC rezulton nuk ka pasur udhëzime të miratuara që të detajojnë procesin e kryer për identifikimin e zgjedhësve me kodet e sipërpërmendura por referohet që punonjësit e ZGJC bëjnë ndryshimet sipas legjislacionit në fuqi. Pra supozohet qytetarët të cilët për të paktën një periudhë 18 mujore nuk janë paraqitur për të marrë shërbime pranë ZGJC të jenë paraqitur në masë, sidomos në 3 mujorin e parë të 2019, dhe të kenë marrë shërbime duke dorëzuar dhe dokumentacionin përkatës që mundëson saktësimin e adresave.

Nga verifikimet e kryera rezulton gjithashtu që në total ka ndryshuar nr i banesës për **350.843** zgjedhës.

Bazuar mbi këto arsye dhe fakti që procesi i identifikimit një numri kaq të madh të kodeve të banesave është realizuar në një kohë shumë të shkurtër është vlerësuar në mënyrë të

vazhdueshme nga ana ime si një element me risk shumë të lartë për cenimin e integritetit të listës së zgjedhësve. Për këtë arsye në mënyrë të vazhdueshme nga ana ime është kërkuar vënia në dispozicion dhe aksesimi i informacionit për çdo zgjedhës që ka pasur një nga kodet e sipër përmendura dhe emrin e përdoruesit të Zyrës të Gjendjes Civile që ka kryer veprimin në sistem dhe datën e veprimit. Siç është sqaruar dhe në raportet e mëparshme nga përfaqësuesit e DPGJC raportohet që është e pamundur të eksportohen këto të dhëna për shkak se mungojnë informacionet e detajuara teknike të ndërtimit, konfigurimit dhe ndërlidhjes të elementeve të bazës të të dhënave dhe sistemit largimin drejt pozicioneve të tjera të punës të punonjësve IT që kanë marrë trinime specifike mbi sistemin.

Pamundësia për identifikimin e nëpunësve që kryejnë ndryshime mbi të dhënat e shtetasve cenon rëndë sigurinë e regjistrimit dhe cenon integritetin e listës së zgjedhësve.

Pavarësisht problematikave të sipërpërmendura, si pasojë e të cilave është e pamundur të vërtetohet plotësisht integriteti dhe cilësia e ndryshimeve të bëra në elementët zgjedhor në bazën e të dhënave dhe procesin e gjenerimit të ekstraktit zgjedhor, mbi listën zyrtare janë bëra analiza dhe verifikime të ndryshme, sipas të cilave rezultojnë që:

- Nga analizimi i ekstrakteve rezultojnë që për zgjedhësit të cilët në fillim të procesit kanë pasur kod banese të paidentifikuar dhe të cilët raportohet që janë identifikuar janë krijuar kode të reja banimi në sistem, pra kode të cilat nuk kanë ekzistuar. Pra rezultojnë që nga ana e stafit të ZGJC në bashkëpunim me zyrat e urbanistikës janë arritur të identifikohen për një periudhë 2 muaj e gjysëm **47747** banesa të reja, të cilat rezultojnë të jenë ndërtesa/objekte të veçanta.
- Nga krahasimi i numrit të kodeve të banesave për QV në ekstraktin e parë rezultojnë që më pak se 1% (38 QV) e tyre kanë kode banesash me numër më të madhe 350. Duke krahasuar për çdo ekstrakt kodin e ri të banesave që është vendosur për zgjedhësit me kode 999,888,000 dhe filtruar ata që kanë kod e ri të banesës mbi 350 rezultojnë që kemi një total prej 4157 kodesh të reja banimi të shtuara me vlera mbi 350 tek të cilat janë regjistruar 13.591 zgjedhës.



Me qëllim verifikimin e këtyre kodeve të banesave nga ana ime i është dërguar një listë me 561 kode QV përfaqësuesve të KQZ në mënyrë të më sigurohet një kopje hartave të cilat dorëzohen nga ana e njësive vendore pranë KQZ. Pas kontakteve dhe takimeve më është bërë me dije se për shkak të burimeve të pakta dhe ngarkesës të madhe është e pamundur skanimi dhe dërgimi i tyre. Në këto kushte nga ana ime është sugjeruar që të më mundësohet kontrolli fizik në ambientet e KQZ i materialeve të kërkuara, zgjidhje për të cilën kam marr mbështetjen nga përfaqësuesit e KQZ. Pas paraqitjes time në ambientet e KQZ, në bashkëpunim dhe në prani të stafit të KQZ, është realizuar kontrolli i dokumentacionit të vënë në dispozicion që ishte dorëzuar nga ana e njësive vendore të zgjedhura për verifikim.


Nga kontrolli i kryer rezulton që në disa raste harta nuk është dorëzuar fare, vetëm në tre raste në format elektronik dhe në rastet e tjera në format letër. Në të gjitha rastet hartat e dorëzuara nuk përmbanin kodet e banesave duke pamundësuar verifikimet e nevojshme. Gjithashtu rezulton që sistemi i publikimit të hartave dhe informacioneve zgjedhore të KQZ (linku: <http://zgjedhje2017.imb.al/GISDefault.aspx>) nuk është përditësuar me të dhënat e 2019.

Si pasojë e mungesës të informacioneve dhe të dhënave si log të veprimeve të përdoruesve të ZGJC dhe hartave zyrtare të përditësuar e bëjnë të pamundur vlerësimin e saktë ndryshimeve të këtyre kodeve dhe shkallën e fiktivitetit.


Në analizat e bëra nga ana ime janë identifikuar një listë me kode banesash të cilat kanë më shumë se 300 banorë të cilat konsiderohen anomali. Nga këto raste, lista me më shumë se 500 banore për kod banese i është dërguar me email DPGJC duke i kërkuar sqarime mbi këto raste dhe objektet në fjalë. Në përgjigje të kërkesës time nga ana e tyre më është bërë me dije se do ngrihen grupe kontrolli për verifikimin e rasteve. Nëpërmjet email të dërguar me datë 30 Maj 2019 nga ana ime është kërkuar informacion mbi rezultatet e grupit të kontrollit. Në përgjigje të dërguar nga ana e DPGJC thuhet që: *lidhur me këtë çështje, ju bëjmë me dije se kontrolli dhe monitorimi që po realizohet nga ana e DPGJC-se është ne proces dhe akoma nuk është konkluduar mbi shqetësimin e paraqitur nga ana juaj.* Ndërkohë duke bërë verifikime të kodeve të banesave për disa raste në sistemin e hartave të KQZ rezulton që këto objekte nuk mund të kenë në asnjë mënyrë atë nr banorësh. Më konkretisht po sjell në vëmendje 3 nga raste si më poshtë:



Në Korçë QV 3636 ka 1051 zgjedhës të regjistruar me numër banese 141 që i përket godinës së Fakultetit të shkencave të natyrës dhe humane dhe 495 zgjedhës të regjistruar me numër banese 529 që siç duket në hartë është lulishte.




Në Durrës QV 1470 ka 944 zgjedhës me numër banese 22 e cila shihet lehtësisht nga fotot ajrore që është godinë shumë e vogël dhe e ka të pamundur të strehojë 944 zgjedhës së bashku me familjet e tyre.





Në Elbasan QV 2350 ka 408 zgjedhës me numër banese 27 e cila është një shkalle pjesë e një godine 6 katëshe ndërtuar para viteve 90 dhe dallohet lehtësisht dhe nga foto ajrore që është godinë qe e ka të pamundur të strehojë 408 zgjedhës së bashku me familjet e tyre.



Pra siç vihet re në të gjitha rastet kemi të bëjmë me raste flagrante pasaktësisht dhe manipulimi të të dhënave të zgjedhësve.

Fakti që është e pamundur të verifikohen hartat dhe kodet e banesave të zgjedhësve dhe gjithashtu nuk mund të verifikohet se si janë ndryshuar kodet e banesave për **350.843 zgjedhës** gjatë periudhës së monitorimit duke pamundësuar verifikimin e ligshmërisë të ndryshimeve në elementët zgjedhor të tyre. Ky numër është mjaft i lartë dhe përfaqëson **10%** të listës së zgjedhjeve.

Një problematikë tjetër e evidentuar nga analizimi i ekstrakteve zgjedhore është përfshirja dhe heqja e zgjedhësve të cilët kanë moshën e votimit mbi 100 vjeç në datën e zgjedhjeve. Kodit Zgjedhor, Neni 51-Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë pika 1 përcakton që: *Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, jo më vonë se 5 ditë nga dita e dekretimit të datës së zgjedhjeve, urdhëron zyrat e gjendjes civile të fillojnë procesin e hartimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë, në përputhje me këtë Kod. Jo më vonë se 15 ditë nga dita e dekretimit, zyra e gjendjes civile nxjerr në format elektronik ekstraktin me përbërësit*



zgjedhorë të të gjithë shtetasve me të drejtë vote në datën e zgjedhjeve, me përjashtim të shtetasve që kanë mbushur 100 vjeç deri në këtë datë. Neni 52- Njoftimi me shkrim i zgjedhësve, Pika 1 përcakton që: Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 51, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore. Njoftim bëhet edhe për shtetasit që kanë mbushur 100 vjeç, sipas të dhënave në RKGjC, duke i njoftuar ata për arsyen e mospërfshirjes në listë. Neni 53- Shkaqet dhe procedurat e ndryshimit në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, pika 3 përcakton që: Shtetasit që nuk janë përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë, për shkak se kanë mbushur moshën 100 vjeç, përfshihen në listën e zgjedhësve të zonës së qendrës së votimit ku kanë vendbanimin, në përputhje me shkronjën "e" të pikës 1 dhe procedurën parashikuar në shkronjën "a" të pikës 2 të këtij neni sipas të cilës a) në rastin e shkronjave "ç", "d", "dh" dhe "e" të pikës 1 të këtij neni, kërkesa për ndryshim të përbërësit zgjedhor bëhet nga shtetasi ose një anëtar madhor i familjes së tij;

Bazuar mbi informacionin e dhënë nga ana e DPGJC, ky grup zgjedhësish hiqet nga ekstrakt i parë duke i vendosur kodin QV 8899 dhe pastaj në vazhdimësi shtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndërkohë po ti referohemi statistikave zyrtare në ekstrakt të datës 28 Prill 2019 rezultojnë si të përjashtuar 1087 zgjedhës ndërsa në ekstrakt të listës finale rezultojnë 2,805 zgjedhës të përjashtuar, pra 1718 më shumë të përjashtuar. Nëpërmjet email të dërguar me datë 30 Maj 2019 nga ana ime është kërkuar informacion mbi këtë situatë. Në përgjigjen me email të dërguar nga DPGJC bëhet me dije se përsa i përket çështjes që parashtrohet, lidhur me ndryshimin e numrit të shtetasve shqiptare me moshe mbi 100 vjeç, ju bëjmë me dije se DPGJC ka realizuar nxjerrjen e listës së emërore të kësaj kategorie dhe ka informuar ZGJC-te për të bërë ndryshimin manual të kodit '8899', proces që nuk ka rezultuar të ketë sjell frytet e veta pozitive. Me mbështetjen e kontraktuesit, nëpërmjet procedurave që ekzekutohen direkt në bazën e të dhënave të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, është mundur ndryshimi automatik i kodit të qv, konkretisht në kodin '8899', për ata shtetas që mbushin ose kalojnë moshën 100 vjeç, deri me datë 30.06.2019. Për këtë kategori shtetasish, që gjate periudhës së ekstrakteve zgjedhore dhe deri në momentin e gjenerimit të listës përfundimtare, është vërtetuar sipas procedurave se janë gjalle, janë përfshirë në listën përfundimtare të zgjedhësve.

Pra siç pranohet dhe nga vetë DPGJC, proceset e përshkruar dhe hapat që janë ndjekur për gjenerimin e listave, janë të pasakta dhe kanë dështuar në realizimin e objektivit të tyre për të garantuar një proces të sigurtë, transparent dhe të saktë.

Nëpërmjet email të dërguar me datë 30 Maj 2019 gjithashtu është kërkuar informacion mbi njoftimin me poste te qytetareve nga ana e njësive vendore dhe raportimet e tyre nqs ka pasur. Në përgjigjen e tyre DPGJC thekson që me gjenerimin e listës përfundimtare te zgjedhësve, DPGJC, mori masat për gjenerimin e njoftimit te zgjedhësve për çdo njësi administrative / bashki. Jemi informuar nga ana e zgjc-ve se janë printuar dhe janë dërguar për tu firmosur nga ana e Kryetarit te Bashkisë dhe me tej për t'u dërguar me poste, ne adrese te zgjedhësve.

Bazuar në Neni 52- Njoftimi me shkrim i zgjedhësve, Pika 1 përcakton që: Brenda 60 ditëve nga publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, sipas pikave 1, 2 dhe 3 të nenit 51, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore kryen lajmërimin me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore. Njoftim bëhet edhe për shtetasit që kanë mbushur 100 vjeç, sipas të dhënave në RKGjC, duke i njoftuar ata për arsyen e mos përfshirjes në listë ky është një proces i cili duhej të realizohej brenda 60 ditëve nga publikimi i i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë të zgjedhësve, pra në fillim të procesit dhe jo në fund të tij. Siç është shprehur dhe në raportet e mëparshme realizimi i këtij procesi, përveçse detyrim ligjor, është një element i rëndësishëm në saktësimin dhe konfirmimin e saktësisë të adresave të zgjedhësve dhe do krijonte besueshmëri dhe transparencë të listave zgjedhore.

### **Opinion**

Siç është dokumentuar administrimi dhe përpunimi i bazës së të dhënave të RKGjC është jo në përputhje me kërkesat teknike dhe administrative të legjislacionin në fuqi. Përveçse shkeljes të legjislacionit kjo ka pamundësuar një vlerësim të plotë të RKGjC si sistemi ku administrohen, përpunohen, mbahen të dhënat e shtetasve dhe nga ku gjëndërohet lista zgjedhore. Gjithashtu kjo ka sjellë limitime në analizat dhe vlerësimet e mundshme mbi ligjshmërinë e veprimeve te përdoruesve mbi elemente zgjedhorë duke cënuar besimin ndaj veprimeve të kryera gjatë proceset të hartimit të listave zgjedhore.

Gjenerimin të ekstraktit zgjedhor, u provua që është një proces i cili kryhet nga një person i vetëm dhe totalisht jashtë sistemit të RKGjC, sistem i cili është i vetmi i njohur ligjërisht. Faza e vetme e cila përfshin RKGjC është ajo procedura e backup, e cila siç është evidentuar dhe në raportet e mëparshme nuk është dokumentuar dhe testuar sipas legjislacionit në fuqi, dhe në vetvete nuk është një procedure e cila lidhet direkt me procesin zgjedhor. Kryerja e të gjithë procesit të



përpunimit dhe përgatitjes të ekstraktit zgjedhor në një ambient jashtë RKGJC krijon mungesë besimi dhe ka rezultuar me probleme të cilat çënojnë korrektësinë e listës së zgjedhësve dhe të cilat janë evidentuara në vazhdimësi gjatë procesit të auditimit.

Gjithashtu kryerja e procesit të përpunimit dhe përgatitjes të ekstraktit zgjedhor siç ndodh aktualisht, jashtë RKGJC, bie ndesh me legjislacionin në fuqi. Mjafton të rikujtojmë këtu që ndonëse pika 2, Nenit 51, i Kodit Zgjedhor përcakton që "Kur ekstrakti i një qendre votimi ka një numër zgjedhësish më të vogël se 200 zgjedhës, RKGJC-ja nuk lejon hartimin e ekstraktit për zonën e qendrës së votimit" në praktikë ky kontroll ekzekutohet manualisht nga ana e IT dhe jo nga ana e asaj çfarë njihet ligjërisht si RKGJC. Siç është evidentuar dhe në raportimet e mëparshme, për shkak se ky kontroll është proces i cili kryhet manualisht, në ekstraktet zgjedhore ka pasur raste të identifikuar ku QV kanë rezultuar mbi apo nën limit. Ndërkohë po ti referohemi Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme Nr. 671, datë 6. 12. 2016 "Për Procedurat e Hartimit të Listave të Zgjedhësve për Zgjedhjet për Kuvendin" procesi i gjenerimit i referohet vazhdimisht RKGJC, ndërkohë që në praktikë ato bëhen jashtë këtij të fundit. Gjithashtu siç pranohet vetë nga IT e GJC në emailin e datës 31.05.2019 në lidhje me problematikën e heqjes të shtetasve mbi 100 vjeç proceset dhe kontrollet e zbatuara për gjenerimin e listës zgjedhore kanë dështuar në realizimin e objektivave të tyre.

Në kundërshtim me deklaratimet e mëparshme ku është raportuar se vetëm përdoruesit e ZGJC kanë të drejtën e ndërhyrjes dhe ndryshimit të dhënave dhe elementëve zgjedhore në rastin e problematikës të për ata shtetas që mbushin ose kalojnë moshën 100 vjeç, deri me datë 30.06.2019 raportohet që me mbështetjen e kontraktuesit, nëpërmjet procedurave që ekzekutohen direkt në bazën e të dhënave të Regjistrisë Kombëtare të Gjendjes Civile, është mundësuar ndryshimi automatik i kodit të QV, konkretisht në kodin '8899'. Pra është realizuar një ndërhyrje në bazën e të dhënave dhe elementeve zgjedhor në kundërshtim me legjislacionin në fuqi duke çënuar rëndë listën e zgjedhësve.



Gjithashtu mos realizimi i procesit të lajmërimit me shkrim për çdo zgjedhës të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të qendrave të votimit në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore sipas Nenit 51 të Kodit Zgjedhor ndikon në mos saktësimin e adresave të zgjedhësve.

Për sa mësipër në përfundim të periudhës së auditimit duke vlerësuar parregullsitë e hasura dhe në pamundësi për të marrë informacionet e kërkuara nga ana ime në zbatim të dispozitave ligjore gjykoj se të gjitha ndërhyrjet e kryera për ndryshimin e elementëve zgjedhorë ku përfshihem rreth 10% e totalit të zgjedhësve dhe gjenerimi i listave me procedura manuale me ndërhyrje te personelit çënojnë rëndë besueshmërinë mbi listën e zgjedhësve dhe mund të krijojnë shkas për pamundësimin e votimit të zgjedhësve dhe problematika gjate procesit te votimit.

#### **Shtojca**

Email 31.5.2019 Statistika mbi listen perfundimtare